

VENDIM
Nr. 360, datë 16.6.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË DY OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË RROGOZHINË
DHE CAKTIMIN E BASHKISË RROGOZHINË SI NJËSI ZBATUESE**

(Ndryshuar me VKM nr. 185, datë 30.3.2022; nr. 663, datë 6.12.2023)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të dy objekteve arsimore në Bashkinë Rrogozhinë, në masën 310 195 212 (treqind e dhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, përkatësisht, për:

a) rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 137 062 762 (njëqind e tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH;

b) rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 173 132 450 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e njëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rindërtimit të dy objekteve arsimore në Bashkinë Rrogozhinë, në masën 62 039 042 (gjashtëdhjetë e dy milionë e tridhjetë e nëntë mijë e dyzet e dy) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, të ndarë, si më poshtë vijon:

a) Për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 27 412 552 (njëzet e shtatë milionë e katërqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH;

b) Për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 34 626 490 (tridhjetë e katër milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 108 173 177 (njëqind e tetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, për financimin e rindërtimit të dy objekteve arsimore në Bashkinë Rrogozhinë, në masën 139 982 993 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, të ndarë, si më poshtë vijon:

a) Për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 1 477 033 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH;

b) Për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 138 505 960 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë e pesëqind e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Caktimin e Bashkisë Rrogozhinë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të këtyre objekteve arsimore.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe